REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**REKTORATI**

Nr. 964/2 Prot. Vlorë, më, 06.07.2022

**VENDIM**

**Nr. 10, datë 30. 06. 2022**

**PËR**
**MIRATIMIN E PROJEKT PROPOZIMIT TË MINIPROJEKTIT "PROMOVIMI I OFERTËS TURISTIKE PËRMES MARKETINGUT TË MEDIAVE SOCIALE. RASTI I BASHKISË VLORË". FAKULTETI I EKONOMISË, DEPARTAMENTI I BIZNESIT.**

Në zbatim të Nenit 2, Nenit 93 pika 1, 2 dhe 3, Nenit 95 pika 1 dhe 2 të LigjiNr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", udhëzimit Nr.29, Datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe referuar shkresës së Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë nr. 76/1 prot, datë 23.06.2022, Rektorati në mbledhjen e datës 30.06.2022,

**VENDOSI**

1. Të miratojë projekt propozimin e miniprojektit "Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë", Departamenti i Biznesit (sipas materialit bashkëlidhur).
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori, Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në UV.
3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Ekonomisë në Universtetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**
**Prof. Dr. Roland ZISI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skelë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
~~ZYRA E PROTOKOLL~~ - ARKIVËS
NR. 909 PROT.
VLORË 27.06.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I EKONOMISË**
**DEKANI**

Nr 761/1 prot.

Vlorë, më 23.06.2022

**Lënda:** Përcjellje per miratim e projekt propozimit të miniprojektit ,''Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë'', Departamenti i Biznesit.

**PROF. DR. ROLAND ZISI**
**REKTOR**
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI",VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 29, më datë 10/09/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë" të MASR, referuar propozimeve në projekt buxhetin e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, për realizimin e miniprojekteve, bashkëngjitur ju përcjell per miratim dhe procedura te metejshme Projekt –propozimin e Departamentit të Biznesit, ,''Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë''.

**DEKANI I FAKULTETIT TE EKONOMISË**

**PROF.DR.ALBERT QARRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I EKONOMISË**
**DEPARTAMENTI I BIZNESIT**

Nr.76 prot.

Vlorë, më 23.06.2022

**Lënda:** Përcjellje per miratim e projekt propozimit të miniprojektit ,"**Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë**", Departamenti i Biznesit.

**PROF.DR. ALBERT QARRI**
**DEKANI**
**FAKULTETI I EKONOMISË**

Në zbatim **të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"**, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 29, më datë 10/09/2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë" të MASR, referuar propozimeve nw projekt buxhetin e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, për realizimin e miniprojekteve, bashkëngjitur ju përcjell per miratim dhe procedura te metejshme:

- Projekt – propozimin e Departamentit të Biznesit, ,"**Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë**"

**DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TE BIZNESIT**
**Prof.Assoc. Fioralba Vela**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

**Promovimi i ofertës turistike përmes marketingut të mediave sociale. Rasti i Bashkisë Vlorë.**

**Qëllimi:**

Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë ndikimin e medias sociale në marketingun e turizmit në Bashkinë Vlorë duke nënvizuar kerkesën dhe ofertën si në konceptin teorik ashtu edhe praktik permes eksperiencave të biznesit dhe klientelës turistike.

**Metodologjia:**Metodologjia e përdorur në hulumtimin e tregut turistik dhe rolit te mediave sociale në marketimin e produktit turistik të Bashkisë Vlorë, kryesosht atij hotelier, do të bazohet në të dhënat sekondare dhe primare lidhur me vleresimin e nevojave të tregut turistik për t'u marketuar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Transforimi i kërkesave ndaj tregut është mbeshtetur nga ndryshimi drastik i mediave sociale dhe i teknologjisë permes mjeteve të komunikimit si smartphone, tablet dhe shumë përdorues të tjerë të medias sociale. Duke konsideruar këtë trend dhe pasojat sinjifikante që drejtojnë kompanitë tek bleresit permes medias sociale është e rëndësishmë të perifrazojmë konsumatorët si konsumatorë social dhe të njohim pritshmëritë e tyre. Kështu kompanitë,apo agjensitë e udhëtimit duhet të kuptojnë influencën qe ka media sociale në strategjitë e tyre për të zhvilluar qasjet e duhura perms strategjive të marketingut. Do të shpërndahen pyetësorë gjatë muajve të sezonit turistik korrik – gusht tek sipërmarrësit turistikë dhe turistët, të cilët do të përpiqen t'i japin përgjigje pyetjeve, të cilat synojnë hetimin e hipotezave :

1.Ekziston një korrelacion ndërmjet Teknologjisë se informacionit dhe turizmit.

2.Media sociale ka një impakt të drejtpërdrejte në marketing për të promovuar turizmin.

Studimi do të strukturohet si më poshtë:

- Pjesa e pare

Një paraqitje e përgjithshme e zhvillimeve rreth fushës së marketingut të mediave sociale në gjeneratën e këtij shekulli.Evoluimi dhe paraqitja teorike e kesaj fushe në botë dhe në vëndin tonë.

Pjesa e dytë:

Ndikimi që ka marketingu i mediave sociale tek turistët dhe sjellja e tyre përgjatë udhëtimeve të tyre. Nëvecanti, arsyet e ndarjes se eksperiencës, rekomandimet,etj

**Rezultatet e pritshme:** Rezultatet e studimit do të shërbejnë për promovimin e përdorimit të mediave sociale dhe dhënien e rekomandimeve për rritjen e aftësimit të pronar/menaxherëve në lidhje me marketingun e mediave sociale, apo të rritjes së ndërgjegjësimit për rolin që ky mjet i ri marketing ka në botën aktuale, duke nënvizuar rolin e drejtpërdrejtë në rritjen e flukseve turistike në Bashkinë Vlorë.

**Kontributi i këtij propozimi:** Ky propozim pritet të japë një kontribut të rëndësishëm dhe të shërbejë si guidë për vlerësimin e nevojave të tregut turistik për të vlerësuar në mënyrën e duhur metodat dhe teknikat e reja marketing për territorin tonë si dhe të theksojë nevojën për aftësim dhe qasje më të madhe ndaj trajnimeve në këtë fushë, të cilat mund të ofrohen nga Universiteti i Vlorës.

Projekt buxheti

| Kosto Stafi /Aktivitet projekti | | |
|---|---|---|
| Aktivitetet për t'u realizuar | Orët për realizimin e aktivitetit Ore/Aktivitet | Kosto për realizimin e aktivitetit |
| Koordinimi i aktiviteteve për implementimin e projektit | | 50 000 |
| Realizimi e aktiviteteve Financiare | | 50 000 |
| Mbledhja e tedhenave sekondare mbi vlerësimin e nevojave të tregut për program studimi | | 50 000 |
| Identifikimi i sakte i mostres qe do te jete dhe objekt studimit referuar burimeve primare dhe sekondare. | | 50 000 |
| Hartimi dhe shperndarja e pyetesorëve per turistet dhe kompanite turistike | | 50 000 |
| Hedhja e pyetesoreve ne google form për secilin focus grup | | 50 000 |
| Krijimi i databazes ne SPSS | | 50 000 |
| Hedhja e te dhënave te mbledhura nga pyetsoret ne database te SPSS | | 50 000 |
| Përpunimi i të dhënave për studimin | | 50 000 |
| Hartimi i raportit me gjetjet dhe përfundimet për studimin | | 50 000 |
| | | **500.000** |
| **Kosto tolale** | | **500.000** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
## REKTORI

Vlorë më, 27.06. 2022

Lënda: Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

**Drejtuar:**

- Senati
- Rektorati
- Këshilli i Etikës
- Rektori
  - **Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal**
  - **Sektori Juridik**
  - **Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore**
    - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
    - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
    - Sektori i IT-së
- **Bordi i Administrimit**
- **Administrator**
  - **Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse**
  - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
  - Sektori i Prokurimeve
  - Sektori i Shërbimeve
  - **Njësia e Auditit të Brendshëm**
- **Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional**
  - **Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve**
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
  - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
  - **Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik**
- **Zv. Rektor Akademik**
  - **Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë**
  - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
  - Sektori i Këshillimit të Karierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
  - **Sektori i Bibliotekes Shkencore**
- **Prof. Asoc. Aurela Saliaj** — **Dekan F.SH.**
  - Kryesekretare F.SH.
- **Prof. Dr. Albert Qarri** — **Dekan F.E**
  - Kryesekretare F.E
- **Prof. As. Armela Panajoti** — **Dekan F.SH.H**
  - Kryesekretare F.SH.H
- **Prof.As. Hajdar Kicaj** — **Dekan F.SH.T.N**
  - Kryesekretare F.SH.T.N

**REKTORI**

**Prof. Dr. Roland ZISI**